



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 26. 05. 2009, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -203

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Ibrahim Makolli,
Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Vezira
Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Elita Vokshi – OSBE dhe Rrezarta Ahmeti (KDI).

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatar dhe Visar Krasniqi

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe i sugjerimeve të dala nga mbledhja e kaluar e Komisionit, si dhe miratimi i rekomandimeve përkatëse,
3. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe i sugjerimeve që kanë të bëjnë me procesin privatizimit të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe shqetësimet e ish – punëtorëve të xeherores “Trepça,”si dhe rekomandimet përkatëse,
4. Njoftim për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës lidhur me ngarkimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojë kërkesën e shoqërisë civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale,
5. Shqyrtimi i ankesave.

Rendi i ditës u miratua me propozimin që të shtohet pika vijuese “Të ndryshme “.
Komisioni u pajtua me rendin e ditës

1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe i sugjerimeve të dala nga mbledhja e kaluar e Komisionit, si dhe miratimi i rekomandimeve përkatëse

Ismet Beqiri – Tha se Komisioni e ka dëgjuar Muhamet Shalën dhe mbeti t'i nxirrte përfundimet lidhur me ankesën e tij.

Mirëpo konsideronte se kjo çështje nuk binte në fushëveprimin e Komisionit. Ankuesi kishte kërkuar të shqyrtohej mënyra si Habitati e largoi nga banesa dhe si u ndanë trojet nga Rektorati.

Pas dëgjimit të përfaqësuesit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, del se banesa e ankuesit ishte e regjistruar në emër të Predrag Lekiqit.

Komisioni duke u bazuar në fakte, ankuesin e udhëzon që t'i drejtohet me padi vërtetimi Gjykatës Komunale në vështrim të neneve 7 dhe 254 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Naim Rrushemi – Duke u ndërlidhur me ankesën e M. Shalës theksoi se Komisioni i ka identifikuar tendencat e shpronësimit të tokës publike, prandaj i propozoi Komisionit të dalë me një rekomandim drejtuar gjykatës dhe të kërkojë ndalimin e shpronësimit të tokës nga prona publike në pronë private.

Sanije Alijaj – U pajtua me diskutimin e kryetarit dhe ngriti shqetësimin, si është e mundur që UP-ja të lëshojë vendim me të cilin ia ndan banesën M. Shalës, kur e ka ditur se banesa është në emrin e dikujt tjetër?

Pas një debati që zhvilloi Komisioni për zgjidhjen e ankesës, vendosi ta nxirrte këtë

P e r f u n d i m

Komisioni konkludoi se shqyrtimi i ankesës nuk bie në fushëveprimin e tij, por i rekomandon Muhamet Shalës që t'i drejtohet gjykatës dhe të konstatojë ekzistimin e një të drejte ose të një raporti juridik, ose vërtetësinë e ndonjë dokumenti.

3 Shqyrtimi i vërejtjeve dhe i sugjerimeve që kanë të bëjnë me procesin privatizimit të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe shqetësimet e ish-punëtorëve të xeherorës "Trepça", si dhe rekomandimet përkatëse.

Kryetari – Tha se është i informuar nga përfaqësuesit e sindikatës së punëtorëve dhe nga zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Theksoi se Komisioni më 09. 08. 2008 e ka pasur në shqyrtim peticionin dhe me rekomandim e ka mbështetur aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt dhe kërkoj të lejohej ekzekutimi i tij.

Prandaj Komisioni lidhur me këtë mori:

V e n d i m

Komisioni kërkon serish zbatimin e rekomandimit të datës 09. 08. 2008, me të cilin e ka mbështetur aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt nr. 469/2005. Komisioni vazhdoi debatin lidhur me shqetësimet e punëtorëve të Kombinatit Trepça, të

konstatuara në raportin e Avokatit të Popullit nr. 1335/04, që i ka konstatuar disa lëshime, që nuk i ka përfillur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të përfshira në Ligjin kundër diskriminimit.

Vezira Emrush – Për raportin e Avokatit të Popullit theksoi se punëtorët ishin të diskriminuar dhe nëse Qeveria ka strategji për punëtorët serbë duhet të ketë edhe për punëtorët e tjerë, pa dallim përkatësie etnike.

Komisioni lidhur me këtë pikë nxori

P ë r f u n d i m

Komisioni e mbështet raportin e Avokatit të Popullit nr. 1335/04, me konstatime faktesh të gjetura lidhur me diskriminim e theksuar nga Ramadan Ademi, e të tjerët. Kërkohej nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës që raporti me rekomandimet të përfshihet në agjendën e seancave plenare dhe lidhur me këtë pikë të lejohet debat.

4 Njoftim për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës lidhur me ngarkimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojë kërkesën e shoqërisë civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale,

Komisioni u njoftua nga kryetari për përfundimin që nxori Kryesia e Kuvendit lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe u propozua që Ibrahim Makolli ta përgatitë raportin për mbledhjen e radhës lidhur me kërkesën e shoqërisë.

Ibrahim Makolli – Duke folur për Ligjin për vetëqeverisjen lokale shtoi se nga 15% të elektoratit, ku parashihet procedura për të ndryshuar, shoqëria civile kërkon 5% të trupit elektorat. Prandaj janë dy çështje që në këtë fazë do të duhej të merreshin parasysh. E para është se ky ligj u takon ligjeve me interes vital dhe në këtë fazë ku jemi në konsiderohen se janë të paprekshme, sepse ekziston frika se do të preken edhe ligjet e tjera. Çështja dytë është se me 5 % nuk mund të bëhen ndryshime dhe shtoi se 10% mund të jetë i qëndrueshëm. Po ashtu ceku se është ligj që buron nga Pakoja e Ahtisaarit.

5 Shqyrtimi i ankesave

Kryetari e ftoi raportuesen ta merrte fjalën dhe t'i njoftonte anëtarët e Komisionit për përmbajtjen e ankesave.

Nerxhivane Dauti - Tha se ankesat i ka shqyrtuar me kujdes. Disa kanë shqetësime për moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe Komisionit i rekomandon që Sanije Dabiqaj dhe Minire Zeka t'i drejtohen gjykatës komunale dhe të kërkojnë ta zbatojnë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Sahadete Sadikaj i rekomandon që me ankesë t'i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës konform Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, si dhe ankesën e Skender Susurit që ia rekomandon KPMK-së për përshpejtimin e procedurës së vendosjes së ankesës.

Ibrahim Makolli dhe Drita Maliqi - Janë të pajtimit me parafolësin që të ftohen udhëheqësit e KPMK- së. Kjo do të ndihmonte që më hollësisht të njoftohemi me fuksonimin e këtij Këshilli, lidhur me moszbatimin e këtyre vendimeve.

Komisioni i mirëpriti arsyetimet e rekomandimeve dhe falënderoi **Nerxhivane Dautin** për punë në zgjidhjen e tyre.

Ishte kërkesë e përgjithësime e diskutueseve që në njërin nga mbledhjet e Komisionit të ftohej edhe KPMK - ja.

6. Të ndryshme

Kryetari – I njoftoi anëtarët për takimin që pati Komisioni Parlamentar për Integritet lidhur me Planin e veprimit, sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Ai propozoi që në mbledhjen radhës të hynte në agjendë me qëllim që t'i përcillet Komisionit funksional.

Elita Vokshi - Vuri në pah se është i nevojshëm organizimi i një vizite studimore në Poloni nga OSBE-ja. Kryetari e mirëpriti këtë propozim dhe ishte i gatshëm t'i përgjigjej kërkesës.

Mbledhja mori fund në orën 15:00

Kryetar i Komisionit

Ismet Beqiri